

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Vlorë, më 05.07.2019

**VENDIM**

**Nr. 32, datë 05.07.2019**


**PËR  
FORMATIN E FOTOVE NË DIPLOMAT/CERTIFIKATAT E LËSHUARA NGA  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**

Mbështetur në nenin 38 në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenin 19 në Statutin e Universitetit 'Ismail Qemali', Vlorë, Senati Akademik në mbledhjen e datës 05.07.2019

**VENDOSI:**

1. Të miratojë formatin e fotove në diplomat/certifikatat e lëshuara nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë si më poshtë specifikuar:

- Me permasa 4 cm x 5 cm.
- Me ngjyra.
- Në fokus. Personi që fotografohet duhet të jetë me fytyrë drejt aparatit.
- Lartësia e kokës ose permasa e fytyrës (matur nga maja e kokës duke përfshirë edhe flokët deri tek pjesa e poshtme e mjekrës) duhet të jetë rreth 3 cm.
- Të jetë foto e nxjerrë brenda 6 muajve të fundit dhe të tregojë pamjen aktuale të personit.
- Të jetë nxjerrë me një sfond të bardhë e të ndriçuar.
- Të jetë nxjerrë me fytyrën që shikon drejtpërdrejt kamerën. Koka e personit nuk duhet të jetë pozicionuar lart, poshtë ose anash.
- Të jetë me një shprehje neutrale të fytyrës dhe me sytë të hapur.
- Me veshje të rregullt.
- Jo shami apo kapele që pengon flokët, përveç veshjeve fetare që vishen çdo ditë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

2. Vendimi protokollet dhe i përcillet për zbatim Zv/rektorit akademik, Drejtorisë së Edukimit, njësive kryesore dhe sekretarive mësimore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. Roland ZISI**

